$$Pk1 = Ok1 \times P_{maxk1} / V_{maxk1}$$

V_{maxk1} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk1} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme autoritetet/entet kontraktore mund të përdorin kriteret e vlerësimit, si më poshtë:

Propozimi Teknik do të ketë 80 pikë

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të operatorit ekonomik

Nënkriteret³

i/a Përvoja për punë të ngjashme

Operatorët ekonomikë, mund të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë

Operatorët ekonomikë mund të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

(ii) Metodologjia e Propozuar

Nënkriteret

ii/a. Përfaqja teknike dhe metodologjia

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit

³ Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit nënkritereve.

ii.c. Organizimi i Stafit

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Operatori ekonomik duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përjasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve, të paraqesin problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përjasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu, duhet të shpjegohet metodologjia që propozojnë të adoptojë dhe të paraqesin kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përjasjen e propozuar, duke mos përsëritur/kopjuar Termat e Referencës

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Operatori ekonomik duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përjasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret.

ii/c. Organizimi dhe Stafit: Operatori ekonomik duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e stafit së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm

b. Eksperienca në fushën përkatëse

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

2. Vlerësimi i Propozimeve Ekonomike kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Propozimi Ekonomik do të ketë 20 pikë

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës së kualifikuar.

SHENIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kritere vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

26. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezultojnë nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

27. Njoftimi i Fituesit

Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

28. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/Kontratës i 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2 Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

29. Procedura e ankesës 1 Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin dhe /ose përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë për t'u ftuar për të paraqitur oferta, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik

3 Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

30 Anulimi i procedurës i 1 Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ entit kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

- a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021 të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të pikës 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në sistemin e prokurimit elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Kërkesës për Pjesëmarrje

Shtojca 2. Ftesa për Ofertë për Kandidatët e përzgjedhur, faza II

Shtojca 3. Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 4. Lista e Çmimeve sipas Elementëve Përbërës të Shërbimit

Shtojca 5. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 6. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojcë 7. Deklaratë mbi disponueshmërinë e Anëtarit të Stafit

Shtojca 8. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 9. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 10. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 11. Formulari i Kritereve Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 12. Formulari i Përmbledhës i Vetdeklarimit

Shtojca 13. Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 14. Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15. Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 17. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 18: Formulari i Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 1

(Shtojca për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik)

FORMULARI I KËRKESES PËR PJESËMARRJE

Emri i **Operatorit Ekonomik** _____

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e autoritetit /entit kontraktor]*

* * *

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Numri i referencës së procedurës / referenca e Lotit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Botimi (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data]

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, në, të nënshkruarit paraqesim shprehjen tonë të interesit për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 2

*(Shtojcë për tu plotësuar nga autoriteti /enti kontraktor vetëm për operatorët ekonomikë të kualifikuar/
përzgjedhur bazuar në kërkesën për pjesëmarrje)*

FORMULAR I FTESËS PËR OFERTË

[Datë]

Drejtuar: *[Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të kualifikuar /përzgjedhur]*

Procedura e prokurimit _____/

Numri i procedurës / referenca e Lotit _____

Në referencë të procedurës së lartpërmendur ju bëjmë me dije se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur në fazën e parë, Ju jeni kualifikuar për fazën ofertuese të kësaj procedure prokurimi.

Për këtë arsye, ju kërkojmë të paraqisni pranë [këtij autoriteti/enti kontraktor]

Emri _____

Adresa _____

Ofertën tuaj, duke marrë në konsideratë si më poshtë:

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertës është:

Data (d/m/v)

Ora: _____

Adresa _____

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin ofertën në formë elektronike në ueb-faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura me mjete elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjuha (ët) e hartimit të ofertës është:

Shqip Anglisht

Tjetër _____

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit janë si më poshtë:

A) ⁴oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

Sipas rëndësisë:

Çmimi pikët

_____ pikët

_____ pikët

_____ pikët

Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë pikët për cdo kriter vlerësimi të përcaktuar.

OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave do të kryhet në bazën e shumës së çmimeve për njësi (Kjo metodë e vlerësimit nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore në rastet kur sasi të janë të vlerësueshme në bazë vjetore sipas përvojës së mëparshme dhe kur Marrëveshja Kuadër është përdorur për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në rast të tillë çmimi më i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët ofruar).

Mbetemi në pritje të marrjes së ofertës suaj.

[Drejtuesi i autoritetit /entit kontraktor]

⁴ Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

Shtojca 3

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik i ftuar për të paraqitur ofertën)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e kontratës;
 3. Kriteret e përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elemetëve përbërës të shërbimit.

- e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementët përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr	Përshkrimi i elementëve përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nëshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
 [*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-
 se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentet e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁷ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

**“FURNIZIM DHE SHËRBIM LAVANDERIE PËR QENDRËN SPITALORE
RAJONALE BERAT”**

Shërbimi që kërkohet të kryhet nga operatori ekonomik që do të kontraktohet sipas grafikëve të përcaktuar me poshte, rregulloreve dhe protokolleve të higjenes dhe manualeve të kujdesit spitalor do të përfshije:

Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e QSR Berat (Njësia Berat dhe Njësia Kuçovë).

Te realizohet shërbimi i larjes së materialit të butë (çarçafë, batanije, mushame e gomuar, përparëse mjeku, kostum infermieri, peceta kirurgjie/obstetrike, peshqira, këllëf jasteku)etj;

Materiali bute duhet te hekurosen dhe Paketohet;

Shpërndarjen e materialit të butë në të gjithë shërbimet e QSRB-së,

Shtimin e shtratit të pacientit/shtratin e mjekut roje;

Ndërrimin e matrialit te bute

Sigurimin e materialit të butë për shtartin e pacientit, personelin shëndetësor si dhe për sallat operatore sipas specifikimeve përkatëse

Shërbimi do të ofrohet 24 ore gjatë 7 (shtatë) ditëve të javës, (operatori ekonomik duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavion, dhe shtrimin e shtratit të pacientit/shtratin e mjekut roje), sipas grafikut të përcaktuar për ndryshimin periodik të materialit të butë në shërbimet përkatëse, dhe sipas kërkesës së Kryeinfermierit të pavionit në rast të ndryshimit të materialit të butë kur bëhet i domosdoshëm për pacientë të veçantë.

Bazuar në kërkesën me lëndë "Kërkesë për rritjen e cilësisë dhe standarteve të QSRB sipas kërkesave të Shërbimeve dhe pavioneve për "Furnizim e shërbim Lavanterie" me Nr. 5176 Prot., datë 30.09.2025, si dhe te kerkesave te pavioneve per sasine e mundeshme per secilin pavion kryesisht ne kerkesat e pavioneve kryesisht te Pavionit te Urgjences me Nr 5378 prot,date10.10.2025,te pavionit Reanimacionit me Nr 5330 prot, date 08.10.2025, te pavionit te Neonatologjise me Nr 5755 prot date 11.11.2025, te pavionit te Obstetrik-Gjinekologjis me Nr 6492 prot, date 31.12.2025, te pavionit te Pathologjis me Nr6471prot date 31.12.2025, te pavionit te Kirurgjise me Nr 6027prot date 03.12.2025, te Poliklinikes me Nr 5380prot, date 13.10.2025, te Pavionit te Pediatrie, ne pavionin e Infektivit me Nr 497prot date 03.02.2026, ne QSR Berat llojet e materialeve të buta për furnizim dhe ato për larje janë si vijon:

Lloji i Materialeve të buta për furnizim:

- Dyshek spitalor
- Dyshek Pediatrik
- Këllëf Mbrojtëse dysheku i gomuar
- Çarçafe shtrati, i poshtëm dhe i sipërm

- Çarçafe zarf
- Jorganë
- Batanije
- Jastekë krevati
- Batanije
- Këllëf Jasteku
- Peshqirë duarsh
- Peshqirë banjo
- Napë
- Robdishama pacienti për Kirurgjin adulte
- Pizhama pacienti
- Pandofla
- Përparëse Mjek
- Kostume personeli
- Kostume Sanitari
- Pandofla Personeli
- Kostume Receptionsist

Lloji i materialeve të buta për larje:

- Për pacientët:
 - Dyshekë
 - Këllëf Mbrojtëse dysheku i gomuar
 - Çarçafe shtrati, i poshtëm dhe i sipërm
 - Batanije
 - Jastekë
 - Këllëfë jasteku
 - Jorgan
 - Çarçafë zarf
 - Robdishama pacienti për Kirurgjin adulte
 - Pizhame pacienti
 - Peshqir duarsh
 - Peshqir banjo
- Për sallat e operacionit:
 - Batanije
 - Përparëse mjeku
 - Kostume mjeku
 - Kostume infermieri
 - Peshqirë
 - Napë
- Për materialin e butë të stafit mjeksor:
 - Përparëse mjeku
 - Kostume mjeku
 - Kostume infermieri/personel ndihmës
 - Kostume sanitare
 - Peshqirë

Në tabelat e mëposhtme janë pasqyruar % e zënies së shtratit bazuar në të dhënat nga sektori i Kostos dhe Statistikave me shkresën Nr.6029 Prot., datë 03.12.2025, shpeshësia e ndërrimit në ditë si dhe sa kg në ditë kërkohen të lahen materiale të buta për secilin pavion mbështetur në udhëzimin nr.141 datë 08.03.2024 të MSHMS “Për përcaktimin e normativave të shërbimit të lavanderisë dhe statndartizimit të uniformave të personelit shëndetësor në institucionet shëndetësore publike me shtretër”. Emërtimet dhe pesha (kg/copë) është bazuar në katalogun e publikuar nga OBP të vitit 2025, gjendjes së inventarit deri më datën 30.11.2025 si dhe në kontratën e suksesshme që kemi në vazhdimësi. Bazuar në sa më lartë, është bërë një përlllogaritje model për peshën totale në kg që do të jetë për t'u larë:

Nr	Materiali i butë	Patologji					Komentet
		% e zënies së shtratit	Nr.i shtreterve	Shpeshësia e ndërrimit	Pesha (kg/cope)	Pesha totale ne kg	Frekuencat e zevendesimit
1	Dyshek	37.14%	85	0.0027	10.179	0.867620298	1x vit & sipas nevojës
2	Këllëf Mbrojtëse dysheku i gomuar	37.14%	85	0.0333	0.703	0.739027133	1x 30 dite & sipas nevojës
3	Jastekë	37.14%	85	0.0082	0.8	0.20709264	3 x vit & sipas nevojës
4	Këllëf Jastiku	37.14%	85	0.3333	0.11	1.157414247	1x3 dite & sipas nevojës
5	Çarçaf shtrati I poshtem	37.14%	85	0.3333	0.826	8.6911288	1x3 dite & sipas nevojës
6	Çarçaf shtrati I siperm	37.14%	85	0.3333	0.749	7.880938827	1x3 dite & sipas nevojës
7	Çarçaf zarf	37.14%	85	0.3333	1.026	10.79551834	1x3 dite & sipas nevojës
8	Jorgan	37.14%	85	0.0082	1.512	0.39140509	3 x vit & sipas nevojës
9	Pizhama pacienti	37.14%	85	0.3333	0.6	6.31316862	1x3 dite & sipas nevojës
10	Peshqir duarsh	37.14%	85	0.3333	0.096	1.010106979	1x3 dite & sipas nevojës
						38.05342097	

Nr	Materiali i butë	KIRURGJI					Komentet
		% e zënies së shtratit	Nr.i shtreterve	Shpeshësia e ndërrimit	Pesha (kg/cope)	Pesha totale ne kg	Frekuencat e zevendesimit
1	Dyshek	25.77%	45	0.0027	10.179	0.318710088	1x vit & sipas nevojës
2	Këllëf Mbrojtëse dysheku i gomuar	25.77%	45	0.0333	0.703	0.271472905	1x 30 dite & sipas nevojës

3	Jastekë	25.77%	45	0.0082	0.8	0.07607304	3 x vit & sipas nevojës
4	Këllëf Jastiku	25.77%	45	0.3333	0.11	0.42516248	1x3 dite & sipas nevojës
5	Çarçaf shtrati I poshtem	25.77%	45	0.3333	0.826	3.19258371	1x3 dite & sipas nevojës
6	Çarçaf shtrati I siperm	25.77%	45	0.3333	0.749	2.894969974	1x3 dite & sipas nevojës
7	Çarçaf zarf	25.77%	45	0.3333	1.026	3.9656064	1x3 dite & sipas nevojës
8	Jorgan	25.77%	45	0.0082	1.512	0.143778046	3 x vit & sipas nevojës
9	Pizhama pacienti	25.77%	45	0.3333	0.6	2.31906807	1x3 dite & sipas nevojës
10	Peshqir duarsh	25.77%	45	0.3333	0.096	0.371050891	1x3 dite & sipas nevojës
						13.9784756	

Nr	Materiali i butë	REANIMACION					Komentet
		% e zënies së shtratis	Nr.i shtreterve	Shpeshtesia e nderrimit	Pesha (kg/cope)	Pesha totale ne kg	Frekuencat e zëvendësimit
1	Dyshek	73.87%	8	0.0027	10.179	0.16241531	1x vit & sipas nevojës
2	Këllëf Mbrojtëse dysheku i gomuar	73.87%	8	0.0333	0.703	0.138343145	1x 30 dite & sipas nevojës
3	Jastekë	73.87%	8	0.0082	0.8	0.038766976	3 x vit & sipas nevojës
4	Këllëf Jastiku	73.87%	8	1	0.11	0.650056	1x dite & sipas nevojës
5	Çarçaf shtrati I poshtem	73.87%	8	1	0.826	4.8813296	1x dite & sipas nevojës
6	Çarçaf shtrati I siperm	73.87%	8	1	0.749	4.4262904	1x dite & sipas nevojës
7	Çarçaf zarf	73.87%	8	1	1.026	6.0632496	1x dite & sipas nevojës
8	Jorgan	73.87%	8	0.0082	1.512	0.073269585	3 x vit & sipas nevojës
9	Pizhama pacienti	73.87%	8	0.3333	0.6	1.181801808	1x3 dite & sipas nevojës
10	Peshqir duarsh	73.87%	8	0.3333	0.096	0.189088289	1x3 dite & sipas nevojës
						17.80461071	

Nr	Materiali I bute	Sh.Lindjes (Sherbimi Obstetrike -gjinekologji)					Komentet
		% e zenies se shtratit	Nr.i shtreterve	Shpeshtesia e nderrimit	Pesha (kg/cope)	Pesha totale ne kg	Frekuencat e zevendesimit
1	Dyshek	40.12%	50	0.0027	10.179	0.551314998	1x vit & sipas nevojës
2	Këllëf Mbrojtëse dysheku gomuar	40.12%	50	0.0333	0.703	0.469602594	1x 30 dite & sipas nevojës
3	Jastekë	40.12%	50	0.0082	0.8	0.1315936	3 x vit & sipas nevojës
4	Çarçaf zarf	40.12%	50	0.3333	1.026	6.859833948	1x3 dite & sipas nevojës
5	Çarçaf shtrati I poshtem	40.12%	50	0.3333	0.826	5.522634348	1x3 dite & sipas nevojës
6	Çarçaf shtrati I siperm	40.12%	50	0.3333	0.749	5.007812502	1x3 dite & sipas nevojës
7	Napë	40.12%	50	5	0.05	5.015	5x dite & sipas nevojës
8	Jorgan	40.12%	50	0.0082	1.512	0.248711904	3 x vit & sipas nevojës
9	Robdishama pacienti për Kirurgjin adulte	40.12%	50	0.3333	0.6	4.0115988	1x3 dite & sipas nevojës
10	Peshqir duarsh	40.12%	50	0.3333	0.096	0.641855808	1x3 dite & sipas nevojës
11	Peshqir banjo	40.12%	50	0.14	0.392	1.1008928	1x jave & sipas nevojës
						29.5608513	

Nr	Materiali I bute	Sh.Lindjes (Sherbimi Neonatologji)					Komentet
		% e zenies se shtratit	Nr.i shtreterve	Shpeshtesia e nderrimit	Pesha (kg/cope)	Pesha totale ne kg	Frekuencat e zevendesimit
1	Dyshek neonatesh	36.97%	20	0.0027	0.380	0.0076	1x vit & sipas nevojës
2	Çarçaf poshtëm neonatësh	36.97%	20	0.3333	0.082	0.2031	1x3 dite & sipas nevojës
3	Çarçaf sipërm neonatësh	36.97%	20	0.3333	0.128	0.3154	1x3 dite & sipas nevojës
4	Batanije për fëmijë	36.97%	20	0.0082	0.720	0.0437	3x vit & sipas nevojës
						0.57	

Nr	Materiali I bute	Pediatria					Komentet
		% e zenies se shtratit	Nr.i shtreterve	Shpeshtesia e nderrimit	Pesha (kg/cope)	Pesha totale ne kg	Frekuencat e zevendesimit
1	Dyshek per pediatri (Dyshek Standart)	62.85%	58	0.0027	10.179	1.001848735	1x vit & sipas nevojës
2	Këllëf Mbrojtëse dysheku i gomuar	62.85%	58	0.0333	0.703	0.853361085	1x 30 dite & sipas nevojës
3	Jastekë	62.85%	58	0.0082	0.8	0.23913168	3 x vit & sipas nevojës
4	Këllëf Jastiku	62.85%	58	0.3333	0.11	1.336476339	1x3 dite & sipas nevojës
5	Çarçaf shtrati I poshtem	62.85%	58	0.3333	0.826	10.03572233	1x3 dite & sipas nevojës
6	Çarçaf shtrati I siperm	62.85%	58	0.3333	0.749	9.10018889	1x3 dite & sipas nevojës
7	Çarçaf zarf	62.85%	58	0.3333	1.026	12.46567931	1x3 dite & sipas nevojës
8	Jorgan	62.85%	58	0.0082	1.512	0.451958875	3x vit & sipas nevojës
9	Pizhama pacienti për fëmijët e Pediatrisë	62.85%	58	0.3333	0.3	3.64493547	1x3 dite & sipas nevojës
10	Peshqir duarsh	62.85%	58	0.3333	0.096	1.16637935	1x3 dite & sipas nevojës
						40.29568206	

Nr	Materiali I bute	Urgjenca, Echo-Grafia					Komentet
		% e zenies se shtratit	Nr.i shtreterve	Shpeshtesia e nderrimit	Pesha (kg/cope)	Pesha totale ne kg	Frekuencat e zevendesimit
1	Dyshek	100.00%	26	0.0027	10.179	0.7145658	1x vit & sipas nevojës
2	Këllëf Mbrojtëse dysheku i gomuar	100.00%	26	0.0333	0.703	0.6086574	1x 30 dite & sipas nevojës
3	Jastekë	100.00%	26	0.0082	0.8	0.17056	3 x vit & sipas nevojës
4	Këllëf Jastiku	100.00%	26	0.3333	0.11	0.953238	1x3 dite & sipas nevojës
5	Batanije	100.00%	26	0.0082	1.08	0.230256	1 x muaj & sipas nevojës

6	Veshje për Koordinator me pacientin	100.00%	1	0.3333	0.6	0.19998	1x3 dite & sipas nevojës
7	Çarçaf shtrati I siperm	100.00%	26	0.5	0.749	9.737	1x 2 dite & sipas nevojës
8	Çarçaf shtrati I poshtem	100.00%	26	0.5	0.826	10.738	1x 2 dite & sipas nevojës
9	Çarçaf shtrati I siperm (Ambulance)	100.00%	10	1	0.749	7.49	1x dite & sipas nevojës
10	Çarçaf shtrati I poshtem (Ambulance)	100.00%	10	1	0.826	8.26	1x dite & sipas nevojës
						39.1022572	

Nr	Materiali i butë	Infektiv					Komentet
		% e zenies se shtratit	Nr.i shtreterve	Shpeshtesia e nderrimit	Pesha (kg/cope)	Pesha totale ne kg	
1	Dyshek	20.09%	30	0.0027	10.179	0.165641849	1x vit & sipas nevojës
2	Këllëf Mbrojtëse dysheku i gomuar	20.09%	30	0.0333	0.703	0.141091467	1x 30 dite & sipas nevojës
3	Jastekë	20.09%	30	0.0082	0.8	0.03953712	3 x vit & sipas nevojës
4	Këllëf Jastiku	20.09%	30	0.3333	0.11	0.220967901	1x3 dite & sipas nevojës
5	Çarçaf shtrati I poshtem	20.09%	30	0.3333	0.826	1.659268057	1x3 dite & sipas nevojës
6	Çarçaf shtrati I siperm	20.09%	30	0.3333	0.749	1.504590526	1x3 dite & sipas nevojës
7	Çarçaf zarf	20.09%	30	0.3333	1.026	2.061027877	1x3 dite & sipas nevojës
8	Jorgan	20.09%	30	0.0082	1.512	0.074725157	3 x vit & sipas nevojës
9	Pizhama pacienti	20.09%	30	0.3333	0.6	1.20527946	1x3 dite & sipas nevojës
10	Peshqir duarsh	20.09%	30	0.3333	0.096	0.192844714	1x3 dite & sipas nevojës
						7.264974127	

Nr	Materiali I bute	Poliklinika					Komentet
		% e zenies se shtratit	Nr.i shtreterve	Shpeshtesia e nderrimit	Pesha (kg/cope)	Pesha totale ne kg	
							Frekuencat e zevendesimit

1	Jastekë	100.00%	21	0.0082	0.800	0.1378	3 x vit & sipas nevojës
2	Këllëf Jastiku	100.00%	21	0.3333	0.110	0.7699	1x3 dite & sipas nevojës
3	Peshqir duarsh	100.00%	21	1.0000	0.096	2.0160	1x dite & sipas nevojës
						2.92	

Në mënyrë të përmblodhur në tabelën e mëposhtme paraqitet sasia e larjeve për çdo shërbim në spital

EMËRTIMI	Pesha total në ditë
Patologjia	38.053
Kirurgji	13.978
Pediatria	40.295
Reanimacioni	17.804
Urgjenca	39.10
Materniteti	29.560
Neonat	0.57
Infektiv	7.264
Poliklinik	2.92
Pesha totale per nje dite	189.544

Në QSR Berat janë dy salla operacioni si më poshtë:

- Salla e operacionit të Kirurgjisë
- Salla e operacionit të Sh.Lindjes

Sasia e materialit që do të lahet për sallat është:

Nr	Materiali i butë	Salla e Kirurgjisë				Komentet
		Pesha (kg/cope)	Nr.i operacioneve	Shpeshtesia e nderrimit	Pesha totale ne kg	
1	Napë	0.05	2.0	5	0.500	5 cope /operacion
2	Batanije	1.08	2.0	2	4.320	1 cope /operacion
3	Përparëse mjeku	0.50	2.0	1	1.000	1 here ne dite
4	Kostume mjeku	0.60	2.0	1	1.200	1 here ne dite

5	Kostume infermieri	0.60	2.0	1	1.200	1 here ne dite
6	Peshqir duarsh	0.096	2.0	5	0.960	5 cope /operacion
					9.18	

Nr	Materiali I bute	Salla e Maternitetit				Pesha totale ne kg	Frekuencat e zevendesimit
		Pesha (kg/cope)	Nr.i operacioneve	Shpeshtesia e nderrimit			
1	Napë	0.05	1.0	5	0.250	5 cope /operacion	
2	Batanije	1.08	1.0	1	1.080	1 cope /operacion	
3	Përparëse mjeku	0.50	1.0	2	1.000	1 here ne dite	
4	Kostume mjeku	0.60	1.0	2	1.200	1 here ne dite	
5	Kostume infermieri	0.60	1.0	2	1.200	1 here ne dite	
6	Peshqir duarsh	0.096	1.0	5	0.480	5 cope /operacion	
					5.21		

Në tabelën e mëposhtme paraqitet e përmblendhur sasia e larjeve për cdo sallë operacioni

EMËRTIMI	Pesha total në ditë
Salla e Kirurgjise	9.18
Salla e Maternitetit	5.21
Pesha totale per nje dite	14.39

Tabela në vijim paraqet sasinë e materialit të butë që do të lahet për stafin mjekësor

1.Stafi Mjekësor

Nr	Veshje personeli	Pesha (kg/cope)	Shpeshtesia e nderrimit	Nr.stafit mjeksor	Pesha totale ne kg	Frekuencat e zevendesimit
1	Perparese mjeku	0.5	0.14	79	5.53	1 here /jave
2	Kostume personeli	0.6	0.14	282	23.69	1 here /jave
3	Peshqir duarsh	0.1	0.28	282	7.90	2 here /jave
					37.11	

2.Sanitar dhe receptionist

Nr	Veshje personeli	Pesha (kg/cope)	Shpeshtesia e nderrimit	Nr.stafit mjeksor	Pesha totale ne kg	Frekuencat e zevendesimit
1	Kostume sanitare	0.6	0.14	46	3.864	1 here /jave
2	Kostume recepsionisti	0.6	0.33	7	1.3999	1x3 dite & sipas nevojës
3	Peshqir duarsh	0.096	0.28	46	1.2365	2 here /jave
					6.50	

Në mënyrë të përmbledhur sasia e materialit të butë që do të lahet për personelin mjekësor është:

EMËRTIMI	Pesha total në ditë
Mjek,infermier	37.11
Sanitar dhe Recepsionist	6.50
Pesha totale për një ditë	43.61

Nisur nga tabelat e mësipërme totali i kg që duhet në ditë sipas shërbimeve është:

EMËRTIMI	Pesha total në ditë
Shërbimet me shtretër	189.54
Sallat e operacionit	14.39
Stafi mjekësor dhe sanitar & recepsionist	43.61
Pesha totale për një ditë	247.54

Nisur nga tabelat e mësipërme totali i kg që duhet në 1 vit është:

Sasia per 1 vite : 247.54 Kg x 365 dite = 90 352.10 Kg

Sasia per 4 vite: 90 352.10 Kg x 4 vite = 361 408.40 Kg

NEVOJAT PËR INVENTAR PËR MATERIALIN E BUTË PËR SHËRBIMET ME SHTRETËR

Nga tabela e përqindjes së zënies së shtretërve dhe nga koeficienti i përdorimit të shtratit të pacientit mbi të cilën kemi percaktuar edhe numrin e shtretërve që duhet të kompletohen, operatori ekonomik duhet të ketë në gjendje për përdorim inventarin e materialit të butë si në vijim:

Nr	Emërtimi	Inventari në përdorim
1	Dyshek	277
2	Dyshek standart per pediatri	64
3	Dyshek neonati	22
4	Jastek	341
5	Jorgan me vatin	341
6	Këllëf dysheku i gomuar	341
7	Këllëf Jastiku	684
8	Çarçaf shtrati I siperm	684
9	Çarçaf shtrati I poshtem	1025
10	Çarçaf i poshtëm neonatësh	66
11	Çarçaf i sipërm neonatësh	44
12	Çarçaf zarf	684
13	Peshqir duarsh Pacienti	173
14	Peshqir duarsh Personeli	370
15	Peshqir banjo	44
16	Robdishama pacienti për adulte	66
17	Pizhama pacienti	110
18	Pizhama pacienti për fëmijët e Pediatrisë	64
19	Pandofla pacienti për adultët	110
20	Pandofla pacienti për Pediatri	64
21	Napë	473
22	Batanije	55
23	Batanije per femije	22
24	Përparëse mjeku	91
25	Kostume mjeku	87
26	Kostume infermieri	222
27	Kostume sanitari	50
28	Kostume Fizioterapisti	3
29	Kostume Receptionsisti	7
30	Veshje për Koordinator me pacientin	2
31	Pandofla personeli	370

Përzgjedhja e jorganëve vatinë bën të domosdoshme përdorimin e carcafëve zarf.

Një fakt i tillë, gjatë sezonit të verës do të sjellë domosdoshmërinë e përdorimit apo mbulimit vetëm me carcafë. Në këto kushte është menduar që çarçaf zarf të përdoren 8 (tetë) muaj ndërsa për periudhën 15 Maj deri në 15 Shtator të përdoren carcaf të thjeshtë pra 4 muaj. Për pasojë carcafët e poshtëm të shtratit të pacientit do të përdoren për 12 muaj, carcafët e sipërm të shtratit të pacientit do të përdoren për 4 muaj, ndërsa carcafet zarf për 8 muajt e tjerë.

NEVOJAT PËR INVENTAR PËR MATERIALIN E BUTË PËR SALLAT OPERATIVE

Nevojat për inventar për materialin e butë për sallat e operacionit në QSRB, janë nxjerrë duke u bazuar në numrin total të operacioneve të kryera në QSRB gjatë dy viteve të fundit sipas të dhënave

të sektorit të statistikës, përbërjen e ekipeve që kryejnë ndërhyrje kirurgjikale 5 (pesë) persona nga të cilët 3 (tre) mjekë dhe 2 (dy) infermierë), frekuencën e daljes nga përdorimi të materialit të butë që do të përdoret në sallat e QSRB, nevojat për material të butë në to do të jetë si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia për ekip për operacion	Frekuenca e zëvendësimit	Sasia totale e inv.në vit (Urgj.+ Bllok operator)
1	Nape	Cope	5 cope per 1/operacion	3 here ne vit (150 cope x 3 muaj)	473
2	Kostumet e ekipit te salles	Cope	45	1 cope per ekip salle (mjek +infermier)	47
3	Pandofla salle	Pale	45	1 pale per ekip salle (mjek +infermier)	47

NEVOJAT PER INVENTAR PER MATERIALIN E BUTE PER PERSONELI MJEKSOR

Nevojat për inventar për material të butë për personelin mjekësor (mjekë, kryeinfermierë, infermierë) janë llogaritur mbi bazën e numrit të punonjësve që ka sot Qendra Spitalore Rajonale Berat sipas strukturës të miratuar nga MSHMS me shkresë Urdhër Nr. 68 datë 10.02.2025 me Nr. 5229/1 Prot., datë 10.02.2025, protokolluar këtu me Nr. 903 Prot., datë 13.02.2025 dhe shkresës me disa ndryshime në organikën e QSR Berat me Urdhër Nr. 512 datë 21.10.2025 me Nr. 3227/2 Prot., datë 21.10.2025, protokolluar këtu me Nr. 5535 Prot., datë 24.10.2025. Duke patur parasysh që personeli shëndetësor dhe personeli sanitar do i jepen 1 (një) përparëse, 1 (një) kostum dhe 1 (një) peshqir, 1 (një) palë shapka me një normë zëvendësimi 1 (një) herë në vit, operatori ekonomik duhet të plotësojë nevojat për inventar të materialit të butë të personelit shëndetësor.

Nr	Emërtimi	Inventar në përdorim	Frekuenca e zëvendësimit	Sasia totale e inv. në vit
1	Përparëse mjeku	79	1 here ne vit	83
2	Kostume infermieri+ recep.	210	1 here ne vit	221
3	Kostume sanitare	46	1 here ne vit	48
4	Pandofla personeli	335	1 here ne vit	352

Sasia e inventarit të parashikuar është bërë në këtë formë: një komplet të jetë në përdorim një të jetë rezervë për cdo rast dhe një të jetë në lavanteri.

Duke u nisur nga numri i shtretërve që duhet të kompletohen operatori ekonomik duhet të ketë gjendje për përdorim inventarin e materialit të butë. Është llogaritur që i gjithë spitali të jetë me kapacitet të plotë shfrytëzimi shtrati dhe për çdo rast emergjence.

Shënim: Për të gjithë zërat e inventarit të materialit të butë me të cilin do të mbulojë shërbimin e Lavanderisë, operatori ekonomik duhet të ketë një rezervë minimale prej 5% të mallit për të siguruar vijueshmërinë në raste epidemie dhe emergjence, kjo sasi është pasqyruar edhe në tabelat e sipërme.

Përveç larjes operatori ekonomik i kontraktuar duhet të ripërtërijë materialin e butë ekzistues sipas tabelës së mëposhtme:

TABELË ME MATERIALE TË BUTA QË DO BLIHEN PËR RINOVIMIN E INVENTARIT EKZISTUES

Nr.	Artikulli	Njesia	Sasia e mbetur që duhet të blihet vitin e parë	Sasia që do blihet vitin e dytë	Sasia që do blihet vitin e tretë	Sasia që do blihet vitin e katërt	Jetegjatesia
1	Dyshekë	copë	277	0	-	-	5 vjet
2	Dyshek standart per pediatri	cope	64	0	-	-	5 vjet
3	Dyshek neonati	cope	22	-	-	-	5 vjet
4	Jastëk	copë	341	-	341	-	2 vjet
5	Jorgane me vatine	cope	341	-	-	-	4 vjet
6	Kellef dysheku	cope	341	341	341	341	1 vit
7	Këllëf jastëku	Copë	684	684	684	684	1/vit
8	Çarçaf shtrati I siperm	Copë	684	684	684	684	1/vit
9	Çarçaf shtrati I poshtem	Copë	1025	1025	1025	1025	1/vit
10	Carcaf neonati I siperm	Cope	44	44	44	44	1/vit
11	Carcaf neonati I poshtem	Cope	66	66	66	66	1/vit
12	Carcafi zarf	Copë	684	684	684	684	1/ vit
13	Peshqir pacienti	cope	173	173	173	173	1/ vit
14	Peshqire duarsh personeli	cope	370	370	370	370	1 vit
15	Peshqire banjo	Copë	44	44	44	44	1 vit
16	Robdishama pacienti per adulte	Copë	66	66	66	66	1/ vit
17	Pizhama pacienti	Copë	110	110	110	110	1/ vit
18	Pizhama pacienti për fëmijët e Pediatrisë	cope	64	64	64	64	1/ vit

19	Pandofla pacienti	pale	110	110	110	110	1/ vit
20	Pandofla pacienti per femijet e Pediatri	cope	64	64	64	64	1/ vit
21	Napë	Copë	(150 copë * 3 muaj) 473	(150 copë * 3 muaj) 473	(150 copë * 3 muaj) 473	(150 copë * 3 muaj) 473	(150 copë x 3 muaj) 12 muaj
22	Batanije	Copë	55	55	55	55	1 vit
23	Batanije per femije	cope	22	22	22	22	4 vjet
24	Përparëse mjeku	copë	91	91	91	91	1 vit
25	Kostume mjeku	Palë	87	87	87	87	1 vit
26	Kostume personeli mjeksor (infermieri)	copë	222	222	222	222	1 vit
27	Kostume sanitare	cope	50	50	50	50	1 vit
28	Kostum Fizioterapisti	cope	3	3	3	3	1 vit
29	Kostum Receptionisti	cope	7	7	7	7	1 vit
30	Veshje per kordinator me pacientin	cope	2	2	2	2	1 vit
31	Pandofla personeli	copë	370	370	370	370	1 vit

SPECIFIKIME TEKNIKE TË MATERIALIT TË BUTË

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Më poshtë janë specifikimet e materialit të butë që do të lahet, blihet dhe zëvendësohet sipas jetëgjatësisë së materialit përkatës dhe kushteve të autoritetit kontraktor.

1. DYSHEK STANDARD SPITALOR TIP 2

Dyshek spitalor tip 2 duhet të përbëhet nga shkumë poliuretani (PU), me 2 shtresave shkumë Poliuretani, të cilat së bashku japin mbështetje dhe rehati për pacientët për një kohë të gjatë shtrimi. Një shtresë e sipërme me shkumë viskoelastike (memory foam), e cila ndihmon në lehtësimin e presionit në shpinë dhe nyje, ndërsa shtresa e poshtme shkumë PU të jetë me densitet të lartë. Mbulesa e dyshekut tekstil me përbërje 100 % polyester me shtrese poliuretani. Mbulesa e dyshekut me zinxhir 360° me kthim pale mundëson inspektim të brendshëm të përshtatshëm të dyshekut .Mbulesa e dyshekut duhet të jetë rezistente ndaj lëngjeve, antibakteriale, antifungale, rezistente ndaj njollave, antistatike, jo



alergjike, jo irrituese dhe pa lateks. Dysheku përdoret vetëm nga njëra anë, e cila mundëson dhe qarkullimin e ajrit. Ky konstruksion i veçantë i sipërfaqes lejon ventilim më të mirë, duke e mbajtur temperaturën e trupit konstante, si dhe siguron lëvizje më të lirshme dhe rehati.


Specifikimet teknike:			
Nr.	Karakteristikat:	Vlerat:	Metoda e testimit:
1	Ngjyra	E paspecifikuar	Organoleptike
2	Materiali i dyshekut	Mbulesa e dyshekut:100% (PES) e laminuar PU	ISO 1833
		Shkumë Poliuretani (PU) me dy shtresa me densitet të ndryshëm.	
